

TRANSPAROMETRI KOMUNAL 2020

&

Transparenca
e komunave
në retrospektivë





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse
dhe luftës kundër korrupsion përmes
promovimit të transparencës,
llogaridhënies dhe integritetit në të
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2021 . KOSOVA DEMOCRATIC INSTITUTE (KDI)

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 237,
10000, Prishtinë, Kosovë.

Tel.: +381 (0)38 248 038

E-mail: info@kdi-kosova.org

Web: www.kdi-kosova.org

Layout and design: **envinion**

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Olof Palme International Center (OPC). Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI- dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

PËRMBAJTJA

6

LISTA E SHKURTESAVE

7

HYRJE

8

METODOLOGJIA

9

MATJA DHE POENTIMI

10

LISTA E INDIKATORËVE

12

VLERËSIMI I
TRANSPARENCËS SË
KOMUNAVE PËR VITIN
2020

14

TË GJETURAT
KRYESORE

22

Komuna e Rahovecit

23

Komuna e Drenasit

24

Komuna e Lipjanit

25

Komuna e Gjakovës

26

Komuna e Mitrovicës
së Jugut

27

Komuna e Pejës

28

Komuna e Prishtinës

29

Komuna e Hani i Elezit

30

Komuna e Vushtrisë

31

Komuna e Skenderajt

32

Komuna e Ferizajt

33

Komuna e Kaçanikut

34

Komuna e Gjilanit

35

Komuna e Vitisë

36

Komuna e Shtimës

37

Komuna e Malishevës

38

Komuna e Suharekës

39

Komuna e Graçanicës

40

Komuna e Kamenicës

41

Komuna e Podujevës

42

Komuna e Istogut

43

Komuna e Klinës

44

Komuna e Prizrenit

45

Komuna e Deçanit

46

Komuna e Dragashit

47

Komuna e Junikut

48

Komuna e Obiliqit

49

Komuna e Mamushës

50

Komuna e Fushë
Kosovës

51

Komuna e Novo
Bërdos

52

Komuna e Leposaviqit

53

Komuna e Shtërpces

54

Komuna e Zveçanit

55

Komuna e Klllokotit

56

Komuna e Ranillugut

57

Komuna e Parteshit

58

Komuna e Zubin Potok

59

Komuna e Mitrovicës
së Veriut

60

REKOMANDIMET

LISTA E SHKURTESAVE

KAB

Korniza Afatmesme Buxhetore

LVL

Ligji për Vetëqeverisje Lokale

MPL

Ministria e Pushtetit Lokal

ZIP

Zyra për Informim Publik

ZIE

Zyra për Integrime Evropiane

HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia e institucioneve publike janë parakushtet kyçe për qeverisje të mirë dhe demokraci. Duke qenë të hapura dhe transparente, institucionet publike i kontribuojnë nxitjes së bashkëpunimit në mes të qytetarëve dhe institucioneve, duke mundësuar kështu pjesëmarrje më të madhe në vendimmarrje. Rrjedhimisht ndikojnë në rritjen e besimit të publikut në institucione.

Institucionet lokale shërbejnë si mekanizma kryesore, ku qytetarët adresojnë kërkesat për zgjidhjen e problemeve të përditshme që afektojnë ata dhe komunitetin e tyre.¹ Duke qenë transparente, institucionet u mundësojnë qytetarëve qasje në informacionet që kanë të bëjnë me qeverisjen. E informacioni është mjet thelbësor në duart e publikut për të kërkuar llogari dhe për të ekspozuar keqpërdorimet me resurset publike.

Në anën tjetër, niveli i ulët i transparencës ndikon negativisht në jetën e qytetarëve ashtu sikurse edhe në vitalitetin dhe funksionimin e institucioneve të qeverisjes lokale.

Korniza ligjore e Republikës së Kosovës garanton institucione transparente karshi qytetarëve të saj. Kushtetuta, ligji për vetëqeverisja lokale, ligji për qasje në dokumente publike, e udhëzime të tjera administrative legjitimojnë këtë garancion si dhe sigurojnë qytetarët me mjetet e nevojshme ligjore për të kërkuar transparencë dhe llogaridhënie nga institucionet e qeverisjes lokale në Kosovë.

Duke qenë promovuese e këtyre vlerave e synimeve, KDI-ja për vite me rradhë ka matur nivelin e transparencës në 38 komuna të Kosovës. Këto matje periodike i kanë kontribuar jo pak progresit të institucioneve lokale në të qenit më të hapura dhe më të përgjegjshme në përmbushjen e standardeve për qeverisje më transparente. KDI-ja shpreson që rezultatet e këtij Transparometri, i cili përveç matjeve për 2020, ofron edhe të dhëna krahasuese për tre vitet e fundit (2018-2020) do të vazhdojnë t'u shërbejnë komunave si udhërrëfyes dhe motivim për të ngritur performancën e tyre dhe për të kultivuar bashkëpunimin me qytetarët drejt një vendim-marrjeje më kualitative.

¹ KDI, "Transparometri komunal", 2017. http://kdi-kosova.org/ep-content/uploads/2018/02/Transparometri-ALB-ALL-SMALL_Fin.pdf

METODOLOGJIA

Ky hulumtim është realizuar në të gjithë 38 komunat e Republikës së Kosovës gjatë periudhës mars – prill 2021. Performanca e institucioneve komunale gjatë vitit 2020 është vlerësuar në bazë të 48 indikatorëve, bazuar në metodologjinë e Transparency International dhe në praktikat shumëvjeçare të KDI. Për dallim nga vitet para-prake, matjet për vitin 2020 janë realizuar nga konsorciumi i OJQ-ve "Aleanca Qytetare për Transparencë" i përbërë nga Instituti Demokratik i Kosovës dhe nëntë (9) organizata lokale partnere: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, Iniciativa Qytetare Skenderaj (IQS), Forumi i Organizatave Jo-qeveritare Kaçanik (FOJK), Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP), SHL-Kosova, Rrjeti i OJQ-ve AVONET, Initiative for Social Education – ISEP si dhe OJQ SOFRA.

Procesi i vlerësimit të përmbushjes së indikatorëve për 34 komunat me shumicë shqiptare, ka ndjekur një metodologji standarde duke shfrytëzuar metodat adekuate për mbledhjen e të dhënave. Janë monitoruar ueb faqet zyrtare të komunave (të administruara nga Ministria e Administratës Publike), janë realizuar intervista me akterë komunalë, janë dërguar kërkesa tek autoritetet lokale për qasje në informata/dokumente publike ndërsa është monitoruar edhe puna e institucioneve komunale.

Për shkak të kontekstit politik që mbizotëron në katër komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës², vlerësimi i indikatorëve është bazuar në metodologji të njëjtë por duke shfrytëzuar burime alternative siç janë ueb faqet jozyrtare të këtyre komunave: <https://www.ezubinpotok.com/>; <http://www.ezvecan.com/>; <https://www.eleposavic.com/> dhe <http://www.esevenamitrovica.com/>, të cilat administrohen nga OJQ-ja New Social Initiative³ me seli në Mitrovicën e Veriut.

Korniza ligjore e cila është konsultuar gjatë përcaktimit të indikatorëve përfshin: Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale; Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; Ligjin Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike; Ligji Nr. 02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve; Udhëzimi Administrativ (MPL) NR. 03/2020 Për Transparencë në Komuna; Udhëzimin Administrativ të MAP nr. 01/2015 për Ueb faqet e institucioneve publike; Vendimin e Qeverisë 07/87 mbi miratimin e Kartës për Hapjen e të Dhënave; Rregulloren (QRK) nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ndërkohë, **analiza krahasuese** për tre vitet e fundit (2018-2020) lidhur me transparencën komunale është e bazuar në të dhënat e Transparometrit Komunal 2018 (për 11⁴ komunat, respektivisht 6⁵ komunat e Republikës së Kosovës), Transparometrit Komunal 2019⁶ për 38 komuna e Republikës së Kosovës dhe matjet e vitit 2020, pjesë e këtij punimi. Për shkak të mungesës së të dhënave për vitin 2018 për 21 komuna, vetëm 17 komuna janë vlerësuar për performancën tre-vjeçare. Ndërsa të gjitha 38 komunat janë analizuar për performancën e tyre dyvjeçare, 2019 dhe 2020.

2 Zubin Potok, Leposaviq, Mitrovice e Veriut, Zveçan

3 <http://newsocialinitiative.org/>

4 Për më tepër shih Transparometri Komunal 2018, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/02/FINAL-Per-WEB-05-Transparometri-Komunal-2018-ALB-08.pdf>

5 Për më tepër shih Transparometri Komunal 2018, <https://kdi-kosova.org/publikimet/transparometri-komunal-prizren-peje-gjakove-suhareke-rahovec-decan/>

6 Për më tepër shih Transparometri Komunal 2019, <https://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2020/03/16-Transparometri-Komunal-2019-ALB-09.pdf>

MATJA DHE POENTIMI

Lidhur me secilin indikator, komunat janë poentuar me **0 deri në 2 pikë**, varësisht nga niveli i informacionit që ato kanë ofruar apo sa ka qenë i qasshëm. Komunat të cilat nuk kanë ofruar asnjë informacion lidhur me një indikator të caktuar janë poentuar me **0 pikë**. Kur informacioni ka qenë i pjesshëm, komunat janë poentuar me **1 pikë**, ndërsa kur informacioni ka qenë i plotë, komunat janë poentuar me **2 pikë**.



Rezultati maksimal për një
Komunë për të gjithë 48
indikatorët është




96 PIKË

Rezultati minimal për
një Komunë për të gjithë
indikatorët është



0 PIKË





LISTA E INDIKATORËVE:

- 1 A janë publikuar njoftimet për seancat e Kuvendit të Komunës dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së seancave?
- 2 A i është bashkëngjitur njoftimeve për seanca të Kuvendit të Komunës materiali përcjellës?
- 3 A është bërë informimi i publikut për seancat e Kuvendit të Komunës në vendet më të frekuentuara nga qytetarët, përmes mediave dhe rrjeteve sociale?
- 4 A janë publikuar njoftimet për mbledhjet e Komitetit për Politikë e Financa dhe rendi i ditës, 7 ditë para mbajtjes së mbledhjeve?
- 5 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës 10 seanca të rregullta gjatë vitit, siç parashihet me ligj?
- 6 A janë mbledhjet e Komiteteve të përhershme të hapura për publikun?
- 7 A janë të publikuara në ueb faqen e komunës të dhënat për të gjithë këshilltarët e Kuvendit të Komunës (emri, mbiemri, data e lindjes, emaili, adresa e banimit, numri i telefonit, subjekti politik)?
- 8 A mund të gjendet në ueb faqen zyrtare të komunës një historik i shkurtër për komunën?
- 9 A e ka të publikuar në ueb faqe Kuvendi i Komunës Planin e tij të punës?
- 10 A ka Kuvendi i Komunës një Plan të veprimit për transparencë dhe a është i njëjti publik?
- 11 A janë të publikuara video-linjet e seancave të Kuvendit të Komunës pas mbajtjes së tyre?
- 12 A ka publiku qasje në draft rregulloret e Kuvendit të Komunës?
- 13 A janë publike rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës?
- 14 A publikohen procesverbalet e seancave të Kuvendit të Komunës dhe rezultatet e votimit mbi pikat e rendit të ditës?
- 15 A ka qasje publiku në vendimet e Kuvendit të Komunës?
- 16 A janë seancat e Kuvendi të Komunës të hapura për publikun?
- 17 A transmetohen seancat e Kuvendit të Komunës drejtpërdrejtë, dhe nëse po, përmes çfarë platformave?
- 18 A ka thirrur në raportim Kuvendi i Komunës ose komitetet Kryetarin e Komunës?
- 19 A ka thirrur në raportim Kuvendi i Komunës ose komitetet drejtorët e drejtorive?
- 20 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës diskutime mbi shpenzimet tremujore brenda afateve ligjore?
- 21 A janë të gjitha dokumentet publike të qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 22 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës diskutime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB)?
- 23 A ka mbajtur Kuvendi i Komunës gjatë muajit shtator diskutime publike për buxhetin vjetor për 2020?
- 24 A është bërë konsolidimi i bashkësive lokale dhe a ka informata publike rreth tyre?
- 25 A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografia e Kryetarit/es në ueb faqen zyrtare?





- 26** A janë të publikuara informatat kontaktuese dhe biografitë e drejtorëve të drejtorive komunale në ueb faqen zyrtare?
- 27** A ka në ueb faqe informacione lidhur me çështjet e integritetit në BE dhe ndikimin që ato kanë në qeverisjen komunale?
- 28** A publikohen konkurset e punësimeve, përfshirë kriteret?
- 29** A disponon komuna me koordinatör përgjegjës për qasje në dokumente zyrtare?
- 30** A disponon komuna me një mekanizëm përcjellës për regjistrimin dhe statusin e kërkesave të qytetarëve?
- 31** A ofron komuna qasje të papenguar në dokumente zyrtare?
- 32** A është publik plani vjetor i Kryetarit/es të komunës?
- 33** A është ueb faqja zyrtare e komunës e qasshme në të gjitha gjuhët zyrtare?
- 34** A janë të gjitha vendimet e Kryetarit/es të komunës të qasshme për publikun?
- 35** A është publik borxhi komunal?
- 36** A është publike lista e pronave komunale të dhëna me qira ose në shfrytëzim?
- 37** A janë publike të dhënat për të hyrat vetanake të komunës?
- 38** A janë të qasshme të dhënat e komunës në formatin e Open data (versione të shfrytëzueshme dhe të përpunueshme)?
- 39** A shfrytëzon komuna rrjetet sociale për të komunikuar dhe plasuar informata për qytetarët?
- 40** A janë publike kontaktet e Zyrtarit/es për informim?
- 41** A ka komuna në dispozicion një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët?
- 42** A disponon/publikon komuna me një listë mbi shërbimet që ajo i ofron për qytetarët?
- 43** A disponon/publikon komuna materialin paraprak për dëgjimet buxhetore dhe takimet publike?
- 44** A ka organizuar komuna takimet publike të parapara me ligj?
- 45** A publikon komuna aktivitetet e saj në ueb faqe?
- 46** A ka organizuar ekzekutivi i komunës dëgjime buxhetore për buxhetin vjetor 2020 sipas afateve ligjore?
- 47** A disponon/publikon komuna procesverbale nga dëgjimet buxhetore?
- 48** A është publikuar në ueb faqe buxheti komunal për vitin 2020?



|||||

Komuna	Pikët	Përqindje
Shtime	72	75
Suhareka	70	72.92
Malisheve	70	72.92
Podujeva	69	71.88
Gracanica	69	71.88
Kamenica	69	71.88
Prizreni	68	70.83
Klina	68	70.83
Istog	68	70.83
Deçani	66	68.75
Dragash	64	66.67
Junik	64	66.67
Obiliq	63	65.63
Mamusha	58	60.42
Fushe Kosove	55	57.29
Novo Bërda	54	56.25
Leposavic	53	55.21
Shtërpce	52	54.17
Zvecan	52	54.17
Klllokot	52	54.17
Ranillug	47	48.96
Partesh	45	46.88
Zubin Potok	43	44.79
Mitrovica e Veriut	39	40.63

|||||


TË GJETURAT KRYESORE

Qasja e publikut në Planet e Punës të Kuvendeve të Komunave

Një nga parakushtet për funksionim normal të Kuvendeve të Komunave është hartimi i Planeve të Punës. Kuvendet Komunale janë të obliguara të miratojnë Planet e punës sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale⁷. Në kuadër të planeve të tilla, përcaktohen pikat kryesore që duhet shqyrtuar në seancat rregullta të Kuvendit të Komunës. Për këtë arsye, hartimi i tyre nga organet më të larta vendimmarrëse dhe publikimi i tyre në uebfaqet zyrtare të komunave, e rritë transparencën dhe qasjen e publikut në punën dhe vendimet e përgjithshme të Kuvendeve të Komunave.

Gjatë vitit 2020, shumica e kuvendeve të komunave kanë vazhduar të ofrojnë transparencë qytetarëve për punën e tyre. Publikimin e Planit të punës për vitin 2020, e kanë praktikuar shumica e Kuvendeve të Komunave përkatësisht 26 nga 38, përjashtuar 12 komunat në vijim: Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Obiliq, Novo Bërdë, Ranillug, Mamushë, Klinë, Deçan, Junik dhe Kaçanik.

Qasja në Planet e punës të Kuvendeve të Komunave




⁷ Neni 40 paragrafi 2 pika d

Qasja e publikut në materialet e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale

Publikimi i materialeve⁸ lidhur me pikat e rendit të ditës të mbledhjeve të KK, përveç që e bën qeverisjen të duket më e hapur, e mundëson informimin e qytetarëve për proceset vendimmarrëse në komunën e tyre. Gjatë vitit 2020, vetëm **nëntë (9) nga 38 komunat** e Republikës Kosovës i kanë ofruar këtë mundësi qytetarëve të komunave përkatëse. Këtë praktikë të mirë të kuvendeve e hasim në komunën e Rahovecit, Mitrovicës së Jugut, Kamenicës, Drenasit, Lipjanit, Novo Bërdës, Vitisë, Skënderajt si dhe Hanit të Elezit. Si pjesërisht transparente në këtë indikator mbetet komuna e Fushë Kosovës dhe Vushtrrisë, për shkak të mungesës së publikimit materialeve për gjitha pikat e rendit të ditës si dhe në mos publikimin e rregullt të materialeve përcjellëse me rastin e njoftimit të publikut për mbajtjen e seancave të kuvendeve të komunave. Janë plotë 27 Kuvende të Komunave të cilat gjatë vitit 2020 nuk i kanë ofruar qytetarëve mundësin e informimit dhe qasje në materialet përcjellëse të pikave të rendit të ditës. Kjo qasje, ka minimizuar informimin e qytetarëve për procesin vendimmarrës të kuvendeve të komunave.

Qasja në materialet e mbledhjeve të Kuvendeve Komunale në vitin 2020



Transmetimi online i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Komuna obligohen të ofrojnë transparencë për qytetarët në punën e Kuvendit të Komunës, përkatësisht gjatë punimeve të seancave të kuvendit. Kjo përgjegjësi, në njërin anë rrit angazhimin e qytetarëve për të qenë pjesë e ciklit të vendimmarrjes komunale dhe në anën tjetër mban përgjegjës anëtarët e Kuvendit të Komunës në përmbushjen e mandatit përfaqësues. Të obliguara nga legjislacioni, komuna përmes faqes zyrtare duhet të transmetojë mbledhjet e Kuvendit të Komunës, duke përdorur pajisjet e nevojshme për transmetim⁹. Gjatë vitit 2020, shtatëmbëdhjetë (17) nga tridhjetë e tetë (38) komunat


⁸ Procesverbal, draft vendimet, draft dokumentet në procesin e hartimit të politikave, draft Rregulloret etj.

⁹ Neni 4 paragrafi 8 i Udhëzimit Administrativ Nr. / 2020 pwr transparencë



e Kosovës, nuk kanë arritur të ofrojnë për publikun transmetimet direkte ose video linçet për mbledhjet e Kuvendeve të Komunave. Komuna e Graçanicës, Zubin Potokut, Shtërpçës, Suharekës, Zveçanit, Mitrovica e Veriut, Obiliqit, Podujevës, Novo Bërdës, Ranillugut, Parteshit, Vitisë, Fushë Kosovës, Malishevës, Mamushës, Klinës, Deçanit, janë komunat të cilat nuk kanë publikuar asnjë video link nga mbledhjet e seancave të Kuvendit të Komunës për vitin 2020, derisa pjesërisht të vlerësuar në këtë indikator mbetet komuna e Hanit të Elezit, Junikut, Klllokotit, Shtimes dhe Leposaviqit.

Transmetimi online i mbledhjeve të Kuvendit të Komunës



Përfshirja e Kuvendeve të Komunave në planifikimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore

Të obliguara nga Ligji për vetëqeverisje Lokale¹⁰ për shqyrtimin e Konizës Afatmesme Buxhetore (KAB) si dhe nga Qarkoret Buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, Kuvendet e Komunave kanë për obligim të përfshihen në organizimin e dëgjimeve për KAB dhe draft buxhetin komunal të planifikuar nga ekzekutivi i komunës. Shfrytëzimi i këtyre mundësive ligjore, jep hapësirë që Kuvendet e Komunave të jenë pjesë e planifikimit të buxheteve komunale dhe jo vetëm pjesë e miratimit të tyre në procesin final të planifikimit nga ana e ekzekutivit të komunës. Në këtë kontekst, Kuvendet e Komunave gjatë vitit 2020 nuk janë përfshirë në proceset e planifikimit buxhetor. Nga tridhjetë e tetë (38) komunat e Kosovës vetëm dymbëdhjetë (12), kanë organizuar dhe mbajtur dëgjime për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023. Nga tridhjetë e tetë (38) komunat e Kosovës, njëzet e gjashtë (26) prej tyre nuk kanë organizuar dhe mbajtur dëgjimet për KAB. Komunat e tilla janë: komuna e Dragashit, Vushtrrisë, Gjakovës, Graçanicës, Mitrovicës Jugore, Prishtinës, Shtërpçës, Mitrovicës së Veriut, Gjilanit, Istogut, Shtimes, Podujevës, F.Kosovës, Skenderajt, Malishevës, Prizrenit, Mamushës, Klinës, Deçanit, Junikut si dhe Hanit të Elezit. Pjesërisht e vlerësuar në këtë indikator mbetet komuna e Zveçanit për shkak të organizimit të dëgjimit për KAB bashke me ekzekutivin e komunës.


në komuna, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18373>

10 Shih nenin 52 paragrafi 2, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2530>





Përfshirja e Kuvendeve të Komunave në planifikimet e KAB



Organizimi i dëgjimeve buxhetore


Sipas legjislacionit në fuqi, pas dorëzimit të projekt buxhetit¹¹ për vitet vijuese nga ekzekutivi / kryetari i komunës, kuvendet e komunave kanë për obligim të organizojnë enkas dëgjimet buxhetore për projekt buxhetin e komunës. Nga të dhënat e vitit 2020, shumica dërrmuese e kuvendeve të komunave nuk arritën të përmbushin obligimin e tillë ligjor në organizimin dhe mbajtjen e dëgjimeve për projekt buxhetin e komunës. Nga tridhjetë e tetë (38) komunat e Kosovës vetëm gjashtëmbëdhjetë (16) prej tyre kanë përmbushur këtë obligim ligjor duke organizuar dhe mbajtur dëgjimet buxhetore derisa njëzet e dy (22) kuvende të komunave nuk kanë organizuar dhe mbajtur asnjë dëgjim buxhetore të parapara sipas legjislacionit në fuqi për projekt buxhetin e vitit 2021. Kuvendi i komunës së Dragashit, Ferizajt, Mitrovicës së Jugut, Shtërpçës, Suharekës, Gjilanit, Kamenicës, Istogut, Obiliçit, Shtimës, Podujevës, Vitisë, Fushë Kosovës, Skenderajt, Malishevës, Prizrenit, Mamushës, Klinës, Deçanit, Junikut, dhe Hani i Elezit, janë komunat të cilat nuk kanë organizuar dhe mbajtur asnjë dëgjim buxhetor për projekt buxhetin e vitit 2021 gjatë muajt shtator të viti 2020.

¹¹ 1 shtator të çdo viti kalanderik





Organizimi i dëgjimeve buxhetore nga kuvendet e komunave



Konsolidimi i Këshillave Lokalë

Një ndër mekanizmat më relevant për nxitjen dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset vendimmarrëse mbeten Këshillat Lokal. Nga tridhjetë e tetë (38) komunat e Kosovës, shtatëmbëdhjetë (17) prej tyre nuk kanë arritur të konsolidojnë dhe të publikojnë informatat në ueb faqet e tyre zyrtare për Këshillat Lokal. Pesë (5) komuna janë vlerësuar pjesërisht për shkak të konsolidimit të Këshillave Lokal por mungojnë informatat bazike për këta mekanizma si dhe informatat mbi organizimin e takimeve të përbashkëta të komunës me Këshillat Lokal. Komunat që janë vlerësuar me zero (0) pike në këtë indikator janë: komuna e Dragashit, Vushtrrisë, Prishtinës, Zubin Potokut, Shtërpçës, Leposaviçit, Istogut, Obiliçit, Shtimes, Novo Bërdos, Fushë Kosovës, Skenderajt, Prizrenit, Mamsuhës, Klinës, Junikut. Komunat që janë vlerësuar me një (1) pikë në këtë indikator janë: komuna e Hanit të Elezit, Ranillugut, Podujevës, Lipjanit, Suharekës.

Konsolidimi i Këshillave lokale



Komunat dhe përmbushja e obligimeve rreth integritimeve evropiane

Qeveritë lokal mbeten organe përgjegjëse në përmbushjen e agjendës evropiane. Të ndikuara nga politikat e nivelit qendror dhe zotimet për përmbushjen e obligimeve që ndërlidhën me integritet evropiane, komunat kanë për obligim të raportojnë në baza të rregullta tek institucionet qendrore për ecurinë dhe përmbushjen e obligimeve për proceset integruese. Përkundër obligimeve të tilla, shumica e komunave janë treguar pjesërisht transparente në publikimin e të dhënave në ueb faqet e komunave që ndërlidhen me integritet evropiane. Nga tridhjetë e tetë (38) komuna, vetëm gjashtë (6) komunat janë vlerësuar me maksimum dy (2) pikë në këtë indikator, ku pos kontaktit të zyrtarit për integrim kanë të publikuara në ueb faqet e tyre zyrtare edhe raportet e tilla nga procesi i integritimeve evropiane në nivel lokal, siç është komuna e Gjakovës, Ferizajt, Rahovecit, Mitrovica e Jugut, Drenasit si dhe Istogut. Krahës kësaj, nëntëmbëdhjetë (19) komuna kanë të publikuar vetëm kontaktet e zyrtarit për integrim evropian, të cilat janë vlerësuar me një (1) pikë ndërsa trembëdhjetë (13) komuna janë vlerësuar me zero (0) pikë për shkak të mungesës totale të informacioneve përfshirë edhe mungesën e publikimit të kontaktit të zyrtarit për integrim dhe raporteve.

Komunat dhe përmbushja e obligimeve rreth integritimeve evropiane



Vlerësimi i transparencës së komunave në tre vitet e fundit (2018-2020)

Vlerësimi	2018		2019		2020	
Komuna	Pikët	Përqindje	Pikët	Përqindje	Pikët	Përqindje
Rahoveci	94	79.66	85	88.54	90	93.75
Mitrovica e J.	92	77.97	83	86.46	85	88.54
Prishtina	P/A ¹²	P/A	83	86.46	79	82.29
Drenasi	99	83.89	80	83.33	88	91.67
Malisheve	86	72.88	80	83.33	70	72.92
Viti	P/A	P/A	80	83.33	73	76.04
Gjakova	99	83.89	78	81.25	86	89.58
Peja	78	66.1	78	81.25	83	86.46
Suhareka	74	62.71	78	81.25	70	72.92
Vushtrri	P/A	P/A	78	81.25	77	80.21
Prizreni	74	62.71	77	80.21	68	70.83
Lipjani	P/A	P/A	77	80.21	88	91.67
Gjilani	P/A	P/A	76	79.17	73	76.04
Kacanik	P/A	P/A	75	78.13	74	77.08
Ferizaj	P/A	P/A	74	77.08	75	78.13
Shtime	P/A	P/A	73	76.04	72	75
Kamenica	74	62.71	72	75.00	69	71.88
Klina	81	68.66	72	75.00	68	70.83
Gracanica	64	54.24	69	71.88	69	71.88
Hani i Elezit	P/A	P/A	69	71.88	78	81.25
Dragash	76	64.41	68	70.83	64	66.67

12 Pa aplikueshme

|||||


Vlerësimi	2018		2019		2020	
Komuna	Pikët	Përqindje	Pikët	Përqindje	Pikët	Përqindje
Podujeva	P/A	P/A	67	69.79	69	71.88
Istog	P/A	P/A	66	68.75	68	70.83
Skenderaj	P/A	P/A	66	68.75	76	79.17
Obiliq	63	53.39	65	67.71	63	65.63
Novo Bërda	P/A	P/A	58	60.42	54	56.25
Klllokot	P/A	P/A	56	58.33	52	54.17
Leposavic	P/A	P/A	56	58.33	53	55.21
Zvecan	P/A	P/A	55	57.29	52	54.17
Mamusha	32	27.12	53	55.21	58	60.42
Shterpce	67	56.78	53	55.21	52	54.17
Partesh	P/A	P/A	52	54.17	45	46.88
Ranillugu	P/A	P/A	52	54.17	47	48.96
Deçani	67	56.78	50	52.08	64	66.67
Zubin Potok	P/A	P/A	46	47.92	43	44.79
Fushë Kosova	P/A	P/A	45	46.88	55	57.29
Juniku	P/A	P/A	44	45.83	64	66.67
Mitrovica e V.	P/A	P/A	39	40.63	39	40.63

|||||

Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit, mbetet në mesin e komunave të pakta që ka pasur progres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparometrit komunal ndër vite. Transparenca e komunës së Rahovecit në vitin 2018 përmbushte 79.66 % të indikatorëve dhe ky vit radhitet si ndër vitet me më pak transparencë në këtë komunë. Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 komuna e Rahovecit arriti të rriste përqindjen e përmbushjes së indikatorëve vlerësues në 88.54 %, si sinjal i një angazhimi permanent në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Përkundër sfidave të paraqitura për shkak të pandemisë COVID-19, nga të dhënat rezultoi që komuna e Rahovecit edhe në vitin 2020 ka pasur progres në përmbushjen e indikatorëve me gjithsej 93.75 % të vlerësimit të përgjithshëm krahasuar me dy vitet paraprake përkatësisht në vitin 2018 dhe 2019, duke u renditur si komuna e parë në nivel vendi në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparometrit komunal.

Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2020, ka vazhduar me mos përmbushjen e një (1) indikatorit relevant në shtyllën e ekzekutivit të komunës. Mungesa e pasqyrimit të të dhënave në formatin e "Open Data" është indikator i vetëm që është vlerësuar me zero (0) pikë. Komuna e Rahovecit gjatë vitit 2020, si pjesërisht transparent është treguar edhe në katër (4) indikatorë: në mos pasqyrimin e dokumenteve publike në gjitha gjuhët zyrtare, mungesa e plote e ueb faqes së komunës në gjuhët zyrtare si dhe vonesa në publikimin e buxhetit të komunës për vitin 2020.




Komuna e Drenasit

Komuna e Drenasit mbetet e përkushtuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Nga të dhënat vërehet se komuna e Drenasit që nga viti 2018 ka arritur progres të vazhdueshëm në rritjen e transparencës komunale. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur 82.22% të indikatorëve vlerësues duke u renditur në mesin e komunave me transparencë mesatare. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Drenasit ka arritur të përmbushë 88.33% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje prej mbi 6 % të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është vazhduar edhe në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Drenasit ka arritur të përmbushë 91.67% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një progres prej mbi 3% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Drenasit mbetet ndër komunat që pasqyroj progres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020 si dhe ndër komunat me më së shumti transparencë në nivel vendi.

Përkundër vlerësimit dhe progresit të vazhdueshëm në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale, gjatë vitit 2020 kjo komunë ka vazhduar të mos ofrojë transparencë në dy (2) indikatorët vlerësues. Mos publikimi i të dhënave në formatin "Open Data" si dhe mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira, janë indikatorët që duhet të adresohen nga ana e komunës së Drenasit.

Komuna e Drenasit si pjesërisht transparente është vlerësuar në katër (4) nga 48 indikatorët vlerësues. Mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe mundësinë për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i qasjes së plotë në ueb faqen e komunës në gjuhët zyrtare, publikimi i buxhetit tek vendimet e kuvendit të komunës dhe jo në një link të veçantë, janë indikatorë që janë vlerësuar me nga një (1) pikë, shkaku i mungesës së informative të plota dhe pa mundësisë për të ju qasur lehtë për këta indikatorë.




Komuna e Lipjanit

Edhe komuna e Lipjanit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrën komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 80.21% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Lipjanit ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 10% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur progres nga viti 2020 por edhe në mesin e komunave me më së shumti transparencë të treguar karshi publikut bazuar në metodologjinë dhe indikatorët vlerësues të përdorur në këtë dokument.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Lipjanit në vetëm në një (1) indikator është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit. Mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data" është indikator i që është vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Lipjanit është vlerësuar pjesërisht transparente në pesë (5) indikatorë relevant. Mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare sipas afateve ligjore në ueb faqen e komunës, mos publikimi i dokumenteve në gjitha gjuhët zyrtare, mos publikimi i informatave që ndërlidhen me integritet në BE, mos ekzistimi i një mekanizimi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjelljen e statusit të kërkesave të tilla nga ana e qytetarëve si dhe mungesa e qasjes në ueb faqen e komunës në gjitha gjuhët zyrtare, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës, gjatë tri viteve ka vazhduar me një trend mbi mesatar të përmbushjes së indikatorëve vlerësues duke u renditur ndër komunat më transparente në nivel vendi. Në vitin 2018, komuna e Gjakovës kishte arritur të përmbushë 83.89 % të indikatorëve vlerësues, të dhëna këto që pasqyrojnë angazhimin e qeverisë lokale për një transparencë më të madhe. Megjithatë, krahasuar me 2018, në vitin 2019 kishte një regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vetëm 81.25%. Krahasuar me vitin 2019, Komuna e Gjakovës kishte trend të rritjes në përmbushjen e indikatorëve në vitin 2020, ku nga 81.25 % është vlerësues me 89.58% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale. Komuna e Gjakovës, mbetet komuna e katërt me më së shumti transparencë duke përmbushur shumicën e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Megjithatë, komuna e Gjakovës në vetëm tre (3) nga dyzet e tetë (48) indikatorët vlerësues të indeksit të transparencës komunale është vlerësuar më zero (0) pikë. Kjo komunë ka treguar mungesë të transparencës në publikimit të materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës nga legjislativi, mungesë të transparencës dhe përfshirjes së kuvendit të komunës përkatësisht të KPF-së në organizimin e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) si dhe në mos publikimin e listës së pronave të dhëna me qira nga ana e komunës në ueb faqen e komunës.

Nga dyzet e tetë (48) indikatorët vlerësues të indeksit të transparencës komunale, në katër (4) nga ta , komuna e Gjakovës ka ofruar transparencë të pjesshme. Përkthimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mekanizmi përcjellës i kërkesave, qasjen në ueb faqen e komunës në gjitha gjuhët zyrtare dhe OPEN DATA, janë indikatorët që janë vlerësuar me transparencë të pjesshme dhe që komuna e Gjakovës duhet të bëjë përpjekje për përmirësim të mëtejshme.






Komuna e Mitrovicës së Jugut

Komuna e Mitrovicës së Jugut po ashtu mbetet e përkushtuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Nga të dhënat vërehet se kjo komunë që nga viti 2018 ka arritur progres të vazhdueshëm në rritjen e transparencës komunale. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur 77.97% të indikatorëve vlerësues duke u renditur në mesin e komunave me më së shumti transparencë. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Mitrovicës së Jugut ka arritur të përmbushë 86.46% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje prej mbi 8% të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është vazhduar edhe në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku ka arritur të përmbushë 88.54% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një progres prej 2% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Mitrovicës së Jugut mbetet ndër komunat që pasqyroj progres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020 si dhe ndër top komunat me më së shumti transparencë në nivel vendi. Përkundër vlerësimit dhe progresit të vazhdueshëm në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës komunale, komuna e

Mitrovicës së Jugut vazhdon të mos jetë transparente në tre (3) indikatorët vlerësues. Mungesa e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për KAB nga ana e kuvendit të komunës, mungesa e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin nga kuvendi i komunës si dhe mos hapja e të dhënave në formatin e "Open Data", janë indikatorë që duhet të adresohen nga ana e komunës së Mitrovicës së Jugut, për shkak të vlerësimit me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Komuna e Mitrovicës së Jugut si pjesërisht transparente është vlerësuar në pesë (5) nga 48 indikatorët vlerësues. Mos ofrimi i qasjes në draft Rregulloret komunale, mos diskutimi me kohë i raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave dhe përcjellën e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve si dhe mos ofrimi i ueb faqes në të gjitha gjuhët zyrtare, janë indikatorë që janë vlerësuar me nga një (1) pikë, shkak i mungesës së informatave të plota për këta indikatorë




Komuna e Pejës

Komuna e Pejës, që nga konstituimi i organeve të vetëqeverisjes lokale të dalura pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017, në indeksin e transparencës komunale të vitit 2018 kishte përmbushur vetëm 66.10 % të indikatorët vlerësues. Viti 2018, mbetet viti me më pak transparencë në këtë komunë, ngase në vitin 2019, komuna e Pejës kishte arritur progres të theksuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vlerën prej 81.25 %, ku krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje prej 15 % të përmbushjes së indikatorëve vlerësues në total. Me trend pozitiv në përmbushjen e indikatorëve ishte edhe viti 2020, ku komuna e Pejës ka arritur të përmbushë 86.46 % të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 ka një rritje prej mbi 5 %. Kjo komunë, mbetet ndër komunat e pakta, e cila nga viti në vit ka pasur në mënyrë të vazhdueshme progres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues.

Kuvendi i komunës së Pejës, në vitin 2020 është vlerësuar negativisht në tre (3) nga dyzet e tetë (48) indikatorët

vlerësues. Mos ofrimit të materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës që do të shqyrtohen në seancat e kuvendit të komunës, anashkalimi në disa raste i obligimeve ligjore për thirrjen e seancave të KPF-së si dhe mos ofrimi i te dhënave në konceptin e "Open Data", janë indikatorët e vlerësuar më zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Pejës është vlerësuar pjesërisht transparente në shtatë (7) indikatorë relevant. Mungesa e përcjelljes së vazhdueshme për të diskutuar raportet tre mujore të shpenzimeve buxhetore në kuvendin e komunës, mungesa e pasqyrimin të dokumentacionit në gjuhët zyrtare, mungesa e pasqyrimin të raporteve nga Zyra për Integrim Evropian, mungesa e një mekanizmit përcjellës për të monitoruar statusin e kërkesave nga qytetarët, mungesa e publikimit të vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mungesa e publikimit të listës për pronat komunale të dhëna me qira etj. janë indikatorët që janë vlerësuar pjesërisht të qasshme për publikun gjatë vitit 2020.




Komuna e Prishtinës

Edhe komuna e Prishtinës, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 86.46% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Prishtinës ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 4% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Prishtinës në vetëm pesë (5) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos thirrja e kuvendit në raportim kryetarit e komunës, mos organizimi i dëgjimit

për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesën për qasje në dokumente publike, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Prishtinës është vlerësuar pjesërisht transparente në shtatë (7) indikatorë relevant. Mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare brenda afateve ligjore, mos publikimi i dokumenteve në gjitha gjuhët zyrtare, mos informatat e mjaftueshme për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, mos publikimi në ueb faqen e komunës të Planit të punës së kryetarit, publike mos ofrimi i ueb faqes së komunës në gjuhët tjera zyrtare, mos organizimi i takimeve publike siç përcaktohet me legjislacion, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Hani i Elezit

Edhe komuna e Hanit të Elezit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparenctrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 71.88% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e H. Elezit ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 10% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur progres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Hanit të Elezit në vetëm gjashtë (6) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimit për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i ko-

munës, mos publikimi i listës së pronave të komunës të dhëna me qira në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Hanit të Elezit është vlerësuar pjesërisht transparente në tetë (8) indikatorë relevant. Publikimi i pjesshëm i të dhënave biografike për anëtarë të kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha video linçeve në ueb faqen e komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i informatave të mjaftueshme për proceset integruese në nivel lokal mos ofrimi i një mekanizmi shtese për qytetarët për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, ofrimi i pjesshëm i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i listës së hollësishme në ofrimin e shërbimeve nga ana e gjitha mekanizmave institucional, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Vushtrrisë

Edhe komuna e Vushtrrisë, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 81.25% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Vushtrrisë ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 1% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Vushtrrisë në vetëm dhjetë (10) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i

Këshillave Lokal, mos publikimi i informatave që ndërlidhen me proceset integruese në BE, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data" si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Vushtrrisë është vlerësuar pjesërisht transparente në pesë (5) indikatorë relevant. Publikimi i pjesshëm i të dhënave biografike për anëtarë të kuvendit të komunës, mos publikimi në vazhdimësi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi shtese për qytetarët për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, ofrimi i pjesshëm i ueb faqes në gjuhët zyrtare, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Skenderajt

Edhe komuna e Skenderajt, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transpametrimin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 68.75% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Skenderajt ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 8% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur progres nga viti 2019.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Skenderajt në vetëm gjashtë (6) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i organizimit i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos

organizimi i dëgjimeve buxhetore për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i borxhit publik në ueb faqen e komunës, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira nga ana e komunës, mos ofrimi i një linje pa pagesë për qytetarë, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Skenderajt është vlerësuar pjesërisht transparente në gjashtë (6) indikatorë relevant. Mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për proceset integruese në BE, mos ofrimi i një mekanizmi për regjistrimin e kërkesave dhe përcjelljen e statusit të tyre, mos ofrimi i duhur i ueb faqeve zyrtare në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një liste hollësishme për shërbimet nga secili dikaster komunal, mos publikimi i buxhetit të komunës, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Ferizajt

Edhe komuna e Ferizajt, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrën komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 77.08% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Ferizajt ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 1% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Ferizajt në vetëm shtatë (7) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëg-

jimeve buxhetore për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, dhe mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Ferizajt është vlerësuar pjesërisht transparente në shtatë (7) indikatorë relevant. Mos raportimi në baza të rregullta kohore i kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta, mos ofrimi i të gjitha dokumenteve në gjuhën zyrtare, mos specifikimi i një koordinatorit për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për kërkesat dhe qasjen e qytetarëve në statusin e kërkesave të tyre, mos ofrimi i plotë i ueb faqes në gjuhët zyrtare si dhe publikimi parcial i borxhit publik komunal, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Kaçanikut

Edhe komuna e Kaçanikut, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transpametrimin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të vlerësohet me 78.17% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Në vitin 2020 kjo komunë ka një rënie prej 1% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave me regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues gjatë vitit 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Kaçanikut në plotë nëntë (8) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i dokumenteve në gjuhët tjera zyrtare, mos publikimi i informatave

që lidhen me proceset e integrimeve në BE, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Katër (4) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Kaçanikut është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës sipas afateve ligjore, mos publikimi i raportit me numrin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, mos publikimi i listës së pronave publike të dhëna me qira, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparencë të pjesërisht gjatë vitit 2020.




Komuna e Gjilanit

Si një ndër komunat më të mëdha nga rajoni i Gjilanit, kjo komunë vazhdon të mos i përmbushë të gjithë indikatorët vlerësues në transparencën komunale. Megjithatë nuk ishte pjesë e target komunave për të matur transparencën për vitin 2018, në vitin 2019 komuna e Gjilanit nuk renditet në mesin e top komunave për transparencë komunale. Në vitin 2019, kjo komunë kishte përmbushur vetëm 79.17% të indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, gjatë vitit 2020 komuna e Gjilanit pësoi rënie prej 3% të indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave me regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues gjatë vitit 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, gjatë vitit 2020 komuna e Gjilanit në plotë tetë (8) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mos of-

rimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Shtatë (7) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Gjilanit është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta nga kuvendi i komunës, mos diskutimi i shpenzimeve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore sipas obligimeve ligjore, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për çështjet që ndërlidhen me integritet në Be dhe ndikimi i këtyre proceseve në komunë, mos ofrimi i informatave nga të gjitha mekanizmat institucional në ofrimin e listës së shërbimeve që ofrohen si dhe procedurat e marrjes së shërbimeve të tilla, mos ofrimi i plotë i ueb faqes zyrtare në gjuhët zyrtare, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparentë të pjesërisht gjatë vitit 2020.




Komuna e Vitisë

Edhe për qytetarët e komunës së Vitisë, viti i parë qeverisës nga qeveria lokale e dalur nga zgjedhjet lokale të viti 2017 mbetet një ndër vitet me më pak transparencë. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur vetëm 72.88% të indikatorëve vlerësues. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Vitisë ka arritur të përmbushë 83.33% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje të theksuar prej mbi 10 % të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Vitisë ka arritur të përmbushë vetëm 76.04% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej mbi 7% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Vitisë mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020.

Nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Vitisë është vlerësuar me zero (0) pikë në 11 indikatorë. Mos publikimi i Planit të Veprimit për transparencë komunale, mos transmetimi drejtpërdrejtë i seancave të kuvendit të komunës, mos përfshirja e kuvendit të komunës në dëgjimet buxhetore përkatësisht i Komitetit për Politikë dhe Financa

në organizimin e dëgjimeve buxhetore, mungesa e informative që ndërlidhen me Integrimet në BE, mos publikimi në ueb faqen e komunës listën e pronave komunale të dhëna me qira, mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët, mungesa e publikimit të buxhetit të komunës në ueb faqen e komunës etj. indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020. Në shtatë (7) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Vitisë është vlerësuar pjesërisht transparente. Diskutimet brenda afateve ligjore në kuvendin e komunës i raporteve tre mujore të shëpnzimeve, mos publikimi i tërësishëm i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i të gjitha detajeve biografike për drejtorët e drejtorive komunale, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe mundësinë për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, ueb faqja e komunës jo me qasje të plotë në gjitha gjuhë zyrtare, mos publikimi i tërësishëm dhe i vonshëm i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës si dhe mos publikimi në baza të rregullta të borxhit publik komunal, janë indikatorët të cilët janë vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.




Komuna e Shtimës

Edhe komuna e Shtimës, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrën komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 76.04% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Shtimes ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 1% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Shtimes në vetëm tetë (8) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos thirrja në raportim të kryetarit të komunës, mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve bux-

hetore për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë si dhe mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Shtimes është vlerësuar pjesërisht transparente në tetë (8) indikatorë relevant. Mos informimi në kohë dhe sipas ligjit për mbajtjen e seancave të kuvendit të komunës, mos publikimi i të gjitha video linçeve, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta, mos ofrimi i të gjitha dokumenteve në gjuhën zyrtare, mos informatat e mjaftueshme për proceset integruuese në BE, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për kërkesat dhe qasjen e qytetarëve në statusin e kërkesave të tyre, mos ofrimi i plotë i ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i listës së hollësishme për shërbimet që ofrojnë institucionet, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Malishevës

Edhe për qytetarët e komunës së Malishevës, viti i parë qeverisës nga qeveria lokale e dalur nga zgjedhjet lokale të viti 2017 mbetet një ndër vitet me më pak transparencë. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përbushur vetëm 72.88% të indikatorëve vlerësues. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Malishevës ka arritur të përbushë 83.33% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje të theksuar prej mbi 10 % të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Malishevës ka arritur të përbushë vetëm 72.92% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej mbi 10% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Malishevës mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020.

Nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, edhe komuna e Malishevës është vlerësuar me zero (0) pikë në 11 indikatorë. Mos publikimi i materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i video incizimeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos përkthimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos përfshirja e kuvendit të komunës në or-

ganizimin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB), mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mungesa e hapësirës dhe ofrimit të mundësisë për të ju qasur ueb faqes së komunës në gjuhët tjetër zyrtare, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët, mos mbajtja e dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës si dhe mos publikimi i procesverbaleve në ueb faqen e komunës nga organizimi i dëgjimeve buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Në katër (4) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Malishevës është vlerësuar pjesërisht transparente. Mungesa e informative të mjaftueshme për proceset që ndërlihen me integrimin në BE, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe mundësinë për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, informata të pakta në publikimin e listës së pronave komunale të dhëna me qira, informata të pakta në publikimin e borxhit publik komunal, janë indikatorët në të cilët komuna e Malishevës është vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.





Komuna e Suharekës

Edhe për qytetarët e komunës së Suharekës, viti i parë qeverisës nga qeveria lokale e dalur nga zgjedhjet lokale të viti 2017 mbetet një ndër vitet me më pak transparencë. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përbushur vetëm 62.71% të indikatorëve vlerësues duke u renditur në mesin e komunave me transparencë mesatare. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Suharekës ka arritur të përbushë 81.25% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje të theksuar prej mbi 18 % të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020 komuna e Suharekës ka arritur të përbushë vetëm 72.92% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej mbi 8% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Suharekës mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës gjatë vitit 2020.

Nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, gjatë vitit 2020 komuna e Suharekës është vlerësuar me zero (0) pikë në 11 indikatorë. Mungesa e përcjelljes së materialeve për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i video incizimeve të mbledhjeve të kuvendit, mos raportimi i kryetarit të komunës në

kuvendin e komunës, mos përkthimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos mbajtja e dëgjimeve për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) nga kuvendi I komunës përkatësisht nga Komiteti për Politikë dhe Financa, mungesa e qasjes së ueb faqes në gjuhët zyrtare, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data" si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës në ueb faqen zyrtare, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Komuna e Suharekës si pjesërisht transparente është vlerësuar në tre (3) nga 48 indikatorët vlerësues. Mos publikimin në ueb faqen e komunës i të dhënave biografike për anëtarë të kuvendit të komunës, mungesa e informative të mjaftueshme për proceset që ndërlidhën me integrimin në BE, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe mundësin për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, janë indikatorë që janë vlerësuar me nga një (1) pikë, shkaku i mungesës së informative të plota për këta indikatorë.




Komuna e Graçanicës

Komuna e Graçanicës po ashtu mbetet e përkushtuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Nga të dhënat vërehet se kjo komunë që nga viti 2018 ka arritur progres në rritjen e transparencës komunale. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur 54.24% të indikatorëve vlerësues duke u renditur në mesin e komunave me nivel mesatar të transparencës. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Graçanicës ka arritur të përmbushë 71.88% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje prej mbi 17% të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku ka arritur të ruajë përqindjen e përmbushjes së indikatorëve vlerësues të viti 2019.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Graçanicës në plotë njëmbëdhjetë (11) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të kuvendit të komunës, mos organizimi i dëgjimit për KAB dhe draft buxhetin komunal nga kuvendi i komunës, mos

konsolidimi i Këshillave Lokal, mos ofrimi i informatave për proceset që ndërlidhën me integrimin në BE, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos publikimi i borxhit publik që ka komuna, mos publikimi i listave të pronave të dhëna me qira nga komuna, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linjë direkte pa pagesë për qytetarët si dhe mos ofrimi i materialeve përcjellëse për dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Në pesë (5) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Graçanicës është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos publikimi i të dhënave biografike për të gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim të kryetarit të komunës në baza të rregullta kohore, mos caktimi i koordinators për qasje në dokumente publike dhe mos publikimi i raportit nga numri i kërkesave për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i mundësisë për qytetarët për të shfrytëzuar ndonjë mekanizëm shtesë për të përcjellur statusin e kërkesave të tyre, si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore të organizuara në vitin 2020, janë indikatorët që komuna e Graçanicës është vlerësuar si pjesërisht transparente për vitin 2020.




Komuna e Kamenicës

Edhe për qytetarët e komunës së Kamenicës, viti i parë qeverisës nga qeveria lokale e dalur nga zgjedhjet lokale të viti 2017 mbetet një ndër vitet me më pak transparencë. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përbushur vetëm 62.71% të indikatorëve vlerësues. Me një progres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Kamenicës ka arritur të përbushë 75.00% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje të theksuar prej mbi 12% në përbushjen e indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Kamenicës ka arritur të përbushë vetëm 70.83% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej mbi 5% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Kamenicës mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Kamenicës në plotë tetë (8) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i Planit të vepimit për transparencë, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës nga kuvendi i komunës, mos mbajtja e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) nga ana e kuvendit të komunës, mos mbajtja e dëgjimeve bux-

hetore për projekt buxhetin nga ana e kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i një linjë pa pagesë për qytetarët e komunës, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore si dhe mos publikimi i buxhetit komunal, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020. Në dhjetë (10) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Kamenicës është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos publikimi i të dhënave për gjithë anëtarët e kuvendit, mos publikimi i të gjitha procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos diskutimi në kohë i raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve publike në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i informatave të mjaftueshme për çështjet që ndërlidhen me integrimin në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë përcjellës për përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, mos ofrimi i kushteve të barabarta për qasje në ueb faqen e komunës në gjuhët zyrtare, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data" si dhe mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionin në fuqi, janë indikatorët që komuna e Kamenicës është vlerësuar si pjesërisht transparente për vitin 2020.




Komuna e Podujevës

Edhe komuna e Podujevës, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparimet komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mbi mesatar të indikatorëve vlerësues, me 69.79% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Podujevës ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 2% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur progres nga viti 2019.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Podujevës në plotë nëntë (9) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja e kuvendit në raportim kryetarit të komunës, , mos organizimi i dëgjimit për KAB dhe projekt buxhetin nga

kuvendi i komunës, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës si dhe mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Podujevës është vlerësuar pjesërisht transparente në nëntë (9) indikatorë relevant. Mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare brenda afateve ligjore, mos publikimi i dokumenteve në gjitha gjuhët zyrtare, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos informatat e mjaftueshme për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE, mos publikimi i raportit me numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, mos ofrimi i ueb faqes së komunës në gjuhët tjera zyrtare, mos publikimi i të dhënave të përgjithshme për pronat e dhëna me qira nga ana e komunës si dhe mos organizimi i takimeve publike siç përcaktohet me legjislacion, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Istogut

Komuna e Istogut, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrën komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të mos jetë mjaftueshëm transparente, duke përbushur vetëm 68.75% të indikatorëve vlerësues. Në vitin 2020 kjo komunë ka rrije prej 2% të përbushjes së indikatorëve vlerësues, krahasuar me vitin 2019, duke u renditur në mesin e komunave që kanë pasur progres minimal në përbushjen indikatorëve vlerësues.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Istogu në plotë njëmbëdhjetë (11) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i draft Rregulloreve dhe Rregulloreve komunale në ueb faqen e komunës, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve me qytet-

arë për draft buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, mos publikimi i proces-verbaleve nga dëgjimet, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjashtë (6) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Istogut është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos diskutimi i shpenzimeve tre mujore financiare në baza të rregullta kohore sipas obligimeve ligjore, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, mos ofrimi i plotë i ueb faqes zyrtare në gjuhët zyrtare, mos publikimi i tërësishëm i listës së pronave komunale të dhëna me qira si dhe mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparencë të pjesërisht gjatë vitit 2020.




Komuna e Klinës

Komuna e Klinës mbetet në mesin e komunave e cila ka rënie në përmbushjen e indikatorëve të vlerësimit të transparencës në vitin 2020. Trendi i vitit 2019 i rritjes së përqindjes në përmbushjen e indikatorëve, stagnon në vitin 2020. Nga 68.66 % të përmbushjes së indikatorëve vlerësues të transparencës në vitin 2018, komuna e Klinës në vitin 2019 kishte rritje substanciale në përmbushjen e indikatorëve me 75.00 %, shenjë kjo e cila tregonte për një angazhim dhe seriozitet të komunës për të adresuar të metat në transparencën komunale. Ky trend i rritjes së përqindjes në përmbushjen e indikatorëve nuk vërehet edhe në vitin 2020 si vit i tretë qeverisës pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017. Në vitin 2020 ka regres të lehtë prej mbi 4% të përmbushjes së indikatorëve vlerësues krahasuar me vitin 2019. Kësisoj, komuna e Klinës mbetet ndër komunat që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve në vitin 2020.

Nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, edhe komuna e Klinës është vlerësuar me zero (0) pikë në 11 indikatorë. Mos publikimi i materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2020, mos publikimi i video incizimeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos përfshirja e kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afat-

mesme Buxhetore (KAB), mungesa e konsolidimit të Këshillave Lokal, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mungesa e hapësirës dhe ofrimit të mundësisë për të ju qasur ueb faqes së komunës në gjuhët tjetër zyrtare, mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe mos publikimi i procesverbaleve në ueb faqen e komunës nga organizimi i dëgjimeve buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Në gjashtë (6) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Klinës është vlerësuar pjesërisht transparente. Mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta kohore, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta të përcaktuara sipas legjislacionit, mungesa e publikimit të dokumenteve në gjuhët zyrtare, mungesa e informative të mjaftueshme për proceset që ndërlihdën me Integrimin në BE, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe mundësin për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, ueb faqja e komunës jo e plotë dhe e qasshme në gjuhët zyrtare, janë indikatorët në të cilët komuna e Klinës është vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.






Komuna e Prizrenit

Viti i parë qeverisës mbetet një ndër vitet me më pak transparencë për qytetarët e komunës së Prizrenit. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur vetëm 64.40% të indikatorëve vlerësues duke u renditur në mesin e komunave me transparencë mesatare. Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 komuna e Prizrenit kishte një progres të theksuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues prej 80.21%. Ky trend i rritjes së transparencës në komunën e Prizrenit nuk është mbajtur edhe në vitin 2020. Në këtë vit, krahasuar me vitin 2019 kemi një regres të theksuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues prej mbi 10 % përkatësisht në vitin 2020 janë përmbushur vetëm 70.83% të indikatorëve vlerësues. Nga këto të dhëna, komuna e Prizrenit mbetet ndër komunat e cila ka treguar regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke mos rritur transparencën komunale.

Në vitin 2020, komuna e Prizrenit është vlerësuar me zero (0) pikë në njëmbëdhjetë (11) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues. Mungesa e ofrimit të materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos ofrimi i qasjes në draft Rregulloret komunale, mos ofrimi i qasjes në procesverbalet e mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos diskutimi me

kohë i raporteve tre mujore financiare, mos angazhimi i kuvendit të komunës në organizimin e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i Planit të Punës së kryetarit të komunës, mungesa e të dhënave në formatin "Open Data", mos publikimi i procesverbeleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët e vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Po ashtu, komuna e Prizrenit është vlerësuar pjesërisht transparente në gjashtë (6) nga 48 indikatorë vlerësues. Mungesa e ofrimit të dokumenteve në të gjitha gjuhët zyrtare, mungesa e informatave të mjaftueshme për proceset që ndërlidhen me Integrimin në BE, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për qytetarët për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe ofrimin e mundësisë për përcjelljen e statusit të kërkesave të tyre, mos ofrimi i ueb faqes zyrtarë në gjitha gjuhët zyrtare të komunës sipas standardeve të kërkuara, publikimi me vonës i vendimeve të kryetarit të komunës, mos organizimi i takimeve publike sipas legjislacionit në fuqi, janë indikatorët të cilët janë vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.




Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit, vazhdon të mos jetë transparente për publikun, përkundër progresit minimal që ka treguar në përmbushjen e disa indikatorëve. Në vitin 2018, komuna e Deçanit kishte përmbushur vetëm 56.77 % të indikatorëve vlerësues në transparancën komunal. Krahasuar me vitin 2018, në vitin 2019 kjo komunë tregoi regres të theksuar në përmbushjen e indikatorëve vlerësues të transparencës në vetëm 52.08%. Ketë trend të uljes së përqindjes në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, nuk e kemi edhe në vitin 2020, viti ky i cili mbetet si një nga vitet me përmbushje më të madhe të indikatorëve vlerësues me 66.67 %. Andaj, kjo komunë për gjatë 3 viteve të fundit, ka treguar një trend mesatar në përmbushjen e obligimeve në transparencën komunale, bazuar indikatorët matës të përdorur në indeksin e transparencës komunale.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorë vlerësues, gjatë vitit 2020 komuna e Deçanit është vlerësuar me zero (0) pikë në shtatë (6) prej tyre. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mungesa e publikimit të Planit të Punës së kuvendit për vitin 2020, mungesa e dokumenteve

në gjuhet zyrtare, mungesa e diskutimit të KAB nga KPF, mungesa e publikimit të Planit të punës së kryetarit të komunës, mungesa e një linje direkt pa pagesë për qytetarët, mungesa e publikimit të procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore etj. janë indikatorë që nuk janë përmbushur nga ana e komunës së Deçanit edhe gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Deçanit është vlerësuar pjesërisht transparente në shtatë (7) indikatorë relevant. Mos raportimi në baza të rregullta i kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos diskutimi i raporteve tre mujore financiare në baza të rregullta, mos informatat e mjaftueshme për proceset integruese në BE, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për kërkesat dhe qasjen e qytetarëve në statusin e kërkesave të tyre, publikimi i pjesshëm i listës së pronave komunale të dhëna më qira, mos ofrimi i listës së hollësishme për shërbimet që ofrojnë institucionet, mos organizimi i takimeve publike sipas ligjeve, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Dragashit

Edhe për qytetarët e komunës së Dragashit, viti i parë qeverisës nga qeveria lokale e dalur nga zgjedhjet lokale të viti 2017 mbetet një ndër vitet me më pak transparencë. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur vetëm 64.41% të indikatorëve vlerësues. Me një progres të vogël, në vitin 2019 komuna e Dragashit ka arritur të përmbushë 70.83% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje të theksuar prej mbi 6 % të indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes është stagnuar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Dragashit ka arritur të përmbushë vetëm 66.67% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej mbi 4% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Dragashit mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës gjatë viti 2020. Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Dragashit në plotë 13 indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e publikimit të materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i draft rregulloreve komunale, mos organizimi i diskutimit me qytetarë të Konizës Afatmesme Buxhetore (KAB) nga kuvendi i komunës, mos organizimi i diskutimit me qytetarë të projekt buxhetit të komunës nga kuvendi i komunës, mos përcaktimin e koordina-

torit për qasje në dokumente zyrtare, mos ofrimi i kthimit të përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi në ueb faqen e komunës të listës së pronave dhe objekteve të komunës të dhëna më qira, mungesa e hapjes së të dhënave "Open Data", mos publikimi në ueb faqen e komunës të kontaktit të zyrtarit për informim, mos ofrimi i mundësisë për një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore nga ekzekutivi i komunës si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët në të cilët komuna e Klinës është vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.

Në gjashtë (6) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Dragashit është vlerësuar pjesërisht transparente. Mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, raportim parcial i ekzekutivit në kuvendin e komunës për çështje të caktuara të interesit qytetarë, mos ofrimi i dokumentareve në gjuhët zyrtare, mungesa e informatave për çështjet që ndërlidhen me integritet në BE dhe ndikimet e procesit në komunë, mos ofrimi i një mekanizëm përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe statutit të kërkesave të tyre, ofrimi i pjesshëm i qasjes në ueb faqen e komunës në gjuhë zyrtare, janë indikatorët në të cilët komuna e Dragashit është vlerësuar si pjesërisht transparent në vitin 2020.





Komuna e Junikut

Edhe komuna e Junikut, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparimet komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel nën mesatar të indikatorëve vlerësues, me 45.83% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Junikut ka një progres në vlerësimin e indikatorëve prej 15% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur progres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Junikut në vetëm dhjetë (10) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos ofrimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit për transparencë, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i

komunës, mos organizimi i dëgjimit për buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos ofrimi i qasjes në ueb faqen e komunës në gjuhët tjera zyrtare, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data, mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët si janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Junikut është vlerësuar pjesërisht transparente në dhjetë (10) indikatorë relevant. Mos respektimi i plote i ligjit në thirrjet e kuvendit të komunës si dhe komiteteve obligative, mos publikimi i të gjitha video linçeve, mos raportimi në baza të rregullta kohore të raporteve tre mujore financiare, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos informatat e mjaftueshme për proceset integruese në BE, mos përcaktimi i një zyrtari për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për kërkesat dhe qasjen e qytetarëve në statusin e kërkesave të tyre, mos publikimi i plotë i listës së pronave të dhëna me qira, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Obiliqit

Qytetarët e komunës së Obiliqit, vazhdojnë të mos kenë transparencë të plotë nga qeveria lokale, ku viti 2018, si vit i parë qeverisë është vlerësuar si një ndër vitet me përm-bushje më të vogël të indikatorëve vlerësues. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përm-bushur vetëm 53.39% të indikatorëve vlerësues. Me një progres të vogël, në vitin 2019 komuna e Obiliqit ka arritur të përm-bushë 68.75% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rritje prej mbi 5% në përm-bushjen e indikatorëve vlerësues. Ky trend i rritjes nuk ka vazhduar në vitin e tretë qeverisë përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Obiliqit ka arritur të përm-bushë vetëm 65.63% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej 3% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Obiliqit mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës që nga viti 2018. Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Obiliqit në plotë dymbëdhjetë (12) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përm-bushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të kuvendit të komunës, mos publikimi i dokumenteve në gjuhët zyrtare,

mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i informatave na Zyra për Integrim në BE, mos publikimi i Planit të punës së Kryetarit të Komunës, mos ofrimi i mundësisë për qasje në ueb faqen zyrtare në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data" si dhe mungesa e publikimit të procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Nëntë (9) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Obiliqit është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos publikimi i njoftimeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa sipas legjislacionit, mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i tërësishëm i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës në baza të rregullta kohore, mos thirrja në raportim e drejtorëve të drejtorive komunale, mos publikimi i raportit me numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i mundësive shtesë për qytetarët për të përcjellë statusin e kërkesave të tyre të paraqitura pranë autoriteteve komunale, mos publikimi i kontakteve për zyrtarin dhe ZIP, janë indikatorët që komuna e Obiliqit është vlerësuar si pjesërisht transparente për vitin 2020.




Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës, si një ndër komunat e vogla që ka rezultuar në procesin gjatë procesit të decentralizimit dhe krijimit të komunave të reja, mbetet një ndër komunat e rajonit të Prizrenit me më së paku transparencë. Viti 2018, ishte viti me më së paku përmbushje të indikatorëve vlerësues të transparencës komunale me vetëm 27.12%. Megjithatë, krahasuar me këtë vit, viti 2019 ishte me tendencë rritje duke arritur në 55.21% të indikatorëve vlerësues, me një rritje prej mbi 28% të përmbushjes së indikatorëve vlerësues. Përkundër përmbushjes në nivel mestar të indikatorëve vlerësues, kjo komunë ka pasur trend rritje në vlerësimin e përgjithshëm të transparencës edhe gjatë vitit 2020, duke arritur të përmbush 60.42% të indikatorëve vlerësues të matjes së transparencës komunale. Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Mamushës në plotë gjashtëmbëdhjetë (16) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi drejtpërdrejtë i seancave të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetari të komunës nga kuvendi, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për draft buxhetin e komunës nga

kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i informatave që ndërlidhen me integrimet në BE, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos organizimi sipas ligjit i takimeve publike me qytetarë, mos ofrimi i një linje pa pagesë për qytetarët, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për draft buxhetin e komunës nga ana e ekzekutivit si dhe mos mbajtja dhe publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjashtë (6) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Mamushës është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos informimi i qytetarëve për mbledhjet e kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mos ofrimi i gjithë dokumentacionit në të gjitha gjuhët zyrtare në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i një mekanizmi shtesë për përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, mos ofrimi i plotë i ueb faqes zyrtare në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i informatave nga të gjitha mekanizmat institucional në ofrimin e listës së shërbimeve që ofrohen si dhe procedurat e marrjes së shërbimeve të tilla, mos publikimi i tërësishëm i buxhetit të komunës për vitin 2020 në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparencë të pjesërisht gjatë vitit 2020.




Komuna e Fushë Kosovës

Edhe komuna e Fushë Kosovës, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 nuk kishte arritur të përmbushë as nivelin mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 46.88% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Fushë Kosovës ka një progres të rritjes së vlerësimit të indikatorëve vlerësues prej 11%, duke renditur në mesin e komunave që ka pasur progres nga viti 2019. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel mestar prej vetëm 57.29%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Fushë Kosovës duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Fushë Kosovës në plotë katërmëdhjetë (14) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos përkshkrimi i një historiku të shkurtër për komunën, mos publikimi i Planit të veprimit të transparencë, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos organizimi i dëgjimeve për KAB nga kuvendi i komunës, mos organizimi i dëgjimeve me qytetarë për projekt buxhetin e komunës nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos ofrimi i informatave që ndërlidhen me

integrimet në BE, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i listës së pronave të komunës të dhëna me qira, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës për vitin 2020 në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Dymbëdhjetë (12) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Fushë Kosovës është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos publikimi i të dhënave biografike në ueb faqen e komunës për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha draft Rregulloreve komunale, mos publikimi i gjitha procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha vendimeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim kryetarin e komunës nga kuvendi sipas afateve kohore, mos diskutimi në kohë të raporteve tre mujore financiare në kuvendin e komunës, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për përcjelljen e statusit të kërkesave të qytetareve ndaj autoriteteve komunale, mos azhurimi i ueb faqes në të gjitha gjuhët zyrtare, mos publikimi i kontakteve të ZIP, mos ofrimi i një liste të hollësishme të organeve brenda institucionale në ofrimin e shërbimeve publike, mos organizimi i takimeve publike sic parashihet me ligj, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparencë të pjesërisht gjatë vitit 2020.




Komuna e Novo Bërdos

Edhe komuna e Novo Bërdos, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transpametrimin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë nivelin mbi mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 60.42% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Novo Bërdos ka një regres në vlerësimin e indikatorëve vlerësues prej 4%, duke renditur në mesin e komunave që ka pasur regres nga viti 2019. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel mester prej vetëm 56.25%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Novo Bërdos duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Novo Bërdos në plotë nëntëmbëdhjetë (19) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos përshkrimi i historikut të shkurtër për këtë komunë në uebfaqen e komunës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimtimit për transparencë, mos publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos raportimi i kryetarit të komunës në KPF dhe kuvend, mos organizimi i dëgjimit për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos ofrimi i informatave që ndërlidhen me integrimet në BE, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i borxhit publik komunal në uebfaqen e komunës, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira nga komuna, mungesa e materialeve përcjellëse në organizimin e dëgjimeve buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Novo Bërdos është vlerësuar pjesërisht transparente në katër (4) indikatorë relevant. Mos publikimi i të dhënave biografike për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos thirrja nga kuvendi i komunës në raportim të kryetarit të komunës në baza të rregullta, mos publikimi i raporteve nga kërkesat për qasje në dokumente publike si dhe mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave të qytetarëve dhe përcjelljen e statusit të kërkesave nga ana e qytetarëve, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Leposaviqit

Edhe komuna e Leposaviqit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në bashkëpunim me OJQ Aktiv e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e 4 komunave në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë nivelin mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 58.33% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Leposaviqit ka një regres të në vlerësimin e indikatorëve vlerësues prej 3%, duke renditur në mesin e komunave që ka pasur regres nga viti 2019. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel mestar prej vetëm 55.21%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Leposaviqit duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Leposaviqit në plotë shtatëmbëdhjetë (17) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos respektimi i legjislacionit për thirrjet e mbledhjeve të KPF-së, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit të veprimt të transparencë, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimit drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës

nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mungesa e koordinorit për qasje në dokumentet zyrtare, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumentet publike, mos publikimi në ueb faqen e komunës të Planit të punës së kryetarit të komunës, mungesa e qasjes së ueb faqes së komunës në gjuhët zyrtare, mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.


Nëntë (9) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Leposaviqit është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos publikimi i gjitha thirrjeve të seancave të kuvendit sipas kriterëve ligjore të përcaktuara, mos publikimi i të dhënave biografike në ueb faqen e komunës për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha draft Rregulloreve dhe Rregulloreve komunale, , mos publikimi i gjitha vendimeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i tërësishëm i informatave që ndërlidhen me integritet me BE, mos publikimi i gjitha vendimeve të kryetarit të komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar më transparencë të pjesërisht gjatë vitit 2020.



Komuna e Shtërpces

Qytetarët e komunës së Shtërpces, vazhdojnë të mos kenë transparencë të plotë nga qeveria lokale, ku viti 2018, si vit i parë qeverisës është vlerësuar si një ndër vitet me përmbushje më të lartë të indikatorëve vlerësues. Gjatë vitit 2018, kjo komunë kishte përmbushur vetëm 56.78% të indikatorëve vlerësues. Me një regres të theksuar, në vitin 2019 komuna e Shtërpces ka arritur të përmbushë 55.21% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2018 kishte një rënie prej mbi 1% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Ky trend i rënies ka vazhduar në vitin e tretë qeverisës përkatësisht në vitin 2020, ku komuna e Shtërpces ka arritur të përmbushë vetëm 54.17% të indikatorëve vlerësues dhe krahasuar me vitin 2019 kemi një regres prej 1% të indikatorëve vlerësues. Komuna e Shtërpces mbetet ndër komunat që pasqyroj regres në ofrimin e transparencës që nga viti 2018. Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Shtërpces në plotë nëntëmbëdhjetë (19) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos publikimi i materialeve përcjellëse për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i thirrjeve në kohë për mbledhjet e Komitetit për Politike dhe Financa, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejt i seancave të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e drejtorëve të drejtorive komunale, mos thirrja në raportin e kryetarit të komunës, mos organizimi i dëgjimit për KAB dhe draft buxhetin komunal nga kuvendi i komunës,

mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos ofrimi i informatave për proceset që ndërlidhën me integrimin në BE, mos ofrimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos publikimi i vendimeve të kryetarit në ueb faqen e komunës, mos publikimi i borxhit publik që ka komuna, mos publikimi i listave të pronave të dhëna me qira nga komuna, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos ofrimi i një linjë direkte pa pagesë për qytetarët si dhe mos ofrimi i një liste të hollësishme të ofrimit të shërbimeve nga ana e organeve brenda institucionale të komunës së Shtërpces, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020. Në gjashtë (6) nga dyzet e tetë (48) indikatorë vlerësues, komuna e Shtërpces është vlerësuar si pjesërisht transparente. Mos informimi në kohë dhe sipas legjislacionit i qytetarëve të komunës për mbajtjen e mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i tërësishëm i të dhënave biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i tërësishëm i të dhënave biografike për të gjithë anëtarët e ekzekutivit / drejtorët, mos zyrtarizmi i personit si koordinatör për qasje në dokumente publike si dhe mos publikimi i raportit për numrin e kërkesave për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i mundësisë për qytetarët për të shfrytëzuar ndonjë mekanizëm shtesë për të përcjellur statusin e kërkesave të tyre, si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore të organizuara në vitin 2020, janë indikatorët që komuna e Shtërpces është vlerësuar si pjesërisht transparente për vitin 2020.




Komuna e Zveçanit

Edhe komuna e Zveçanit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparimetrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në bashkëpunim me OJQ AKTIV e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e katër (4) komunave në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë nivelin mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 57.29% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahësuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Zveçanit ka një regres të në vlerësimin e indikatorëve vlerësues prej 12%, duke renditur në mesin e komunave që ka pasur regres nga viti 2019. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel nën mestar prej vetëm 44.79%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Zveçanit duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Zveçanit në tetëmbëdhjetë (18) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit për transparencë, mos publikimi i video linçeve nga seancat e kuvendit

të komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos thirrja në raportim e kryetarit të komunës, mos mbajtja e dëgjimeve për KAB nga kuvendi i komunës, mos caktimi i koordinitorit për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit në ueb faqen e komunës, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqen e komunës, mungesa e ofrimit të ueb faqes së komunës në gjuhët zyrtare, mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira nga ana e komunës, mos publikimi i kontakteve të ZIP, mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë për qytetarët si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Zveçanit është vlerësuar pjesërisht transparente në tetë (8) indikatorë relevant. Mos respektimi i plote i ligjit në thirrjet e kuvendit të komunës si dhe komiteteteve obligative, mos publikimi i të dhënave për gjithë anëtarët e kuvendit të komunës, mos ofrimi i qasjes së plotë në draft Rregulloret, mos ofrimi i qasjes së plotë në vendimet e kuvendit, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos konsolidimi i plotë i Këshillave Lokal, mos informatat e mjaftueshme për proceset integruese në BE, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Klllokotit

Edhe komuna e Klllokotit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparimet komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mesatar të indikatorëve vlerësues, me 58.33% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Klllokotit ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 4% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Klllokotit në tetëmbëdhjetë (18) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i të dhënave biografike për anëtarë të kuvendit të komunës, mos pasqyrimi i një historiku të shkurtër për komunën në ueb faqe, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos transmetimi i drejtpërdrejtë të mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i të dhënave biografike për kryetarin e komunës, mos publikimi i informatave që ndërlidhen me integritet në BE, mos ofrimi i përgjigjeve në kërkesat për

qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira në ueb faqen e komunës, komunës mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë, mos ofrimi i një liste të hollësishme për shërbimet që ofrojnë institucionet, mos publikimi i informatave në ueb faqe zyrtare, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës në ueb faqe, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Klllokotit është vlerësuar pjesërisht transparente në tetë (8) indikatorë relevant. Mos respektimi i plote i ligjit në thirrjet e kuvendit të komunës, mos publikimi i të gjitha video linçeve, mos raportimi në baza të rregullta i kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos raportimi në baza të rregullta i drejtorëve të drejtorive në kuvendin e komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos konsolidimi i plotë i Këshillave Lokal, mos përcaktimi i një zyrtari për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave si dhe përcjelljen statusit të tyre nga ana e qytetarëve, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Ranillugut

Edhe komuna e Ranillugut, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mesatar të indikatorëve vlerësues, me 54.17% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Ranillugut ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 5% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Ranillugut në njëzet (20) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i të dhënave biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos pasqyrimi i një historiku të shkurtër për komunën e ueb faqen zyrtare, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i video linçeve nga seancat e kuvendit të komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i detajeve biografike për ekzekutivin e komunës, mos publikimi i

informatave që ndërlidhen me integrimet në BE, mos ofrimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos publikimi borxhit publik në ueb faqen e komunës, mos publikimi i listës së pronave të dhëna me qira në ueb faqen e komunës, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos publikimi i kontakt të zyrtarit për informim, mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë, mos ofrimi i një liste të hollësishme për shërbimet që ofrojnë institucionet si dhe mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Ranillugut është vlerësuar pjesërisht transparente në nëntë (9) indikatorë relevant. Mos respektimi i plote i ligjit në thirrjet e kuvendit të komunës, mos publikimi në formatin e duhur të Planit të veprimit për transparencë, mos publikimi i të gjitha draft Rregulloreve komunale, mos raportimi në baza të rregullta i kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos raportimi në baza të rregullta i drejtorëve të drejtorive në kuvendin e komunës, mos konsolidimi i plotë i Këshillave Lokal, mos përcaktimi i një zyrtari për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave si dhe përcjelljen statusit të tyre nga ana e qytetarëve, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Parteshit

Edhe komuna e Parteshit, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparimet komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI). Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë një nivel mesatar të indikatorëve vlerësues, me 54.17% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Parteshit ka një regres në vlerësimin e indikatorëve prej 5% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues, duke u renditur në mesin e komunave që ka pasur regres në përmbushjen e indikatorëve vlerësues në vitin 2020.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Parteshit në njëzet e një (21) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos publikimi i të dhënave biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos publikimi i linçeve të video mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejt të mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i draft Rregulloreve komunale, mos organizimi i dëgjimeve buxhetore për KAB nga kuvendi i komunës, mos publikimi i detajeve biografike të kryetarit të komunës, mos publikimi i informatave që ndërlidhen me integritet në BE, mos publikimi i kriterëve në konkur-

set publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës në ueb faqe, mos publikimi i borxhit publik komunal, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos ofrimi i një linjë telefonike pa pagesë, mos ofrimi i një liste të hollësishme të shërbimeve që ofrojnë organet komunale, mos përditësimi i ueb faqës zyrtare, mos publikimi i raporteve nga dëgjimet buxhetore si dhe mos publikimi i buxhetit të komunës në ueb faqen zyrtare, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020

Gjatë vitit 2020, komuna e Parteshit është vlerësuar pjesërisht transparente në tetë (8) indikatorë relevant. Mos respektimi i plote i ligjit në thirrjet e kuvendit të komunës, mos publikimi në formatin e duhur të Planit të veprimit për transparencë, mos raportimi në baza të rregullta të kryetarit të komunës në kuvendin e komunës, mos raportimi në baza të rregullta të drejtorëve në kuvendin e komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos publikimi i të gjitha detajeve biografike për drejtorët e drejtorive komunale, mos përcaktimi i një zyrtari për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave si dhe përcjelljen statusit të tyre nga ana e qytetarëve, mos ofrimi i plotë në gjuhët zyrtare i ueb faqes së komunës, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.






Komuna e Zubin Potok

Edhe komuna e Zubin Potokut, është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale që nga viti 2019 në transparometrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në bashkëpunim me OJQ AKTIV e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e katër (4) komunave në pjesën Veriore të Republikës së Kosovës. Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë nivelin mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 47.92% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Zubin Potokut ka një regres të në vlerësimin e indikatorëve vlerësues prej 3%, duke renditur në mesin e komunave që ka pasur regres nga viti 2019. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel nën mestar prej vetëm 44.79%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Zubin Potokut duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Zubin Potokut në njëzet e një (21) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mos thirrjet e seancave të kuvendit të komunës sipas legjislacionit, mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos thirrjet sipas legjislacionit për KPF, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit, mos publikimi i Planit për transparencë, mos publikimi i video linçeve nga seancat e kuvendit të ko-

munës, mos publikimi i procesverbaleve, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i seancave të kuvendit, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike për ekzekutivin e komunës, mos publikimi i kriterëve të konkurseve, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit, mos qasa në ueb faqen zyrtare në gjuhët zyrtare, mos publikimi i vendimeve të kryetarit të komunës, mos publikimi i listës së pronave komunale të dhëna me qira, mos ofrimi i të dhënave në formatin e "Open Data", mos publikimi i kontakteve të ZIP, mos ofrimi i linjës telefonike pa pagesë për qytetarët, mos ofrimi i listës së hollësishme për shërbimet që ofron institucioni si dhe mos publikimi i aktiviteteve në ueb faqen e komunës, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Zubin Potok është vlerësuar pjesërisht transparente në nëntë (9) indikatorë relevant. Mos publikimi i gjitha detajeve biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos ofrimi i qasjes në gjitha draft Rregulloret Komunale, mos ofrimi i qasjes në gjitha Rregulloret komunale, mos ofrimi i plotë në vendimet e kuvendit të komunës,, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i plotë për proceset integruese në BE, mos përcaktimi i një zyrtari për qasje në dokumente publike, mos ofrimi i një mekanizmi përcjellës për regjistrimin e kërkesave si dhe përcjelljen statusit të tyre nga ana e qytetarëve, mos organizimi i takimeve publike sipas ligjit, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.




Komuna e Mitrovicës së Veriut

2019 në transparimetrin komunal të publikuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) në bashkëpunim me OJQ AKTIV e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e katër (4) komunave në pjesën veriore të Republikës së Kosovës. Si komunë e cila për herë të parë është bërë pjesë e matjes së transparencës komunale, në vitin 2019 kishte arritur të përmbushë nivelin nën mesatar të indikatorëve vlerësues me vetëm 40.63% në përmbushjen e indikatorëve vlerësues. Krahasuar me vitin 2019, në vitin 2020 komuna e Mitrovicës së Veriut ka një trend të njëjtë në vlerësimin e indikatorëve. Megjithatë edhe në vitin 2020, kjo komunë mbetet në përmbushjen e indikatorëve në nivel nën mesatar prej vetëm 40.63%. Si rezultat i këtyre të gjeturave, komuna e Mitrovicës së Veriut duhet të rris angazhimin e saj për të ofruar transparencë me të madhe qytetarëve të saj.

Nga katër dhjetë e tetë (48) indikatorët vlerësues, komuna e Mitrovicës Veriore në njëzet e pesë (25) indikatorë është vlerësuar me zero (0) pikë, duke mos arritur as përmbushjen minimale të vlerësimit në këta indikatorë. Mungesa e materialit përcjellës për pikat e rendit të ditës, mos thirrja sipas ligjit të mbledhjeve të KPF-së, mos publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës, mos publikimi i Planit për transparencë, mos publikimi i video linçeve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos transmetimi i drejtpërdrejtë i mbledhjeve të kuvendit të komunës, mos publikimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kuvendit të komunës, mos thirrja e kryetarit të komunës në raportim nga ana e kuvendit të

komunës, mos mbajtja e dëgjimeve për KAB nga kuvendi i komunës, mos konsolidimi i Këshillave Lokal, mos publikimi i detajeve biografike të drejtorëve, mos publikimi i informatave që lidhen me proceset integruese në BE, mos caktimin e koordinatorit për qasje në dokumente publike, mos kthimi i përgjigjeve në kërkesat për qasje në dokumente publike, mos publikimi i Planit të punës së kryetarit të komunës, mos ofrimi i mundësisë më ju qas ueb faqes së komunës në gjuhët tjera zyrtare, mos publikim i vendimeve të kryetarit, mos publikimi i borgjit publik, mos ofrimi i të dhënave në formatin "Open Data", mos publikimi i kontakteve për ZIP, mos ofrimi i një liste të hollësishme për shërbimet që ofrojnë institucionet, mos ofrimi i një linje telefonike pa pagesë, mos publikimi i procesverbaleve nga dëgjimet buxhetore, janë indikatorët që janë vlerësuar me zero (0) pikë gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, komuna e Mitrovicës së Veriut është vlerësuar pjesërisht transparente në nëntë (9) indikatorë relevant. Mos thirrje e seancave të kuvendit sipas legjislacionit, publikimi i gjitha detajeve biografike për anëtarët e kuvendit të komunës, mos ofrimi i qasjes në gjitha draft Rregulloret komunale, mos ofrimi i plotë në vendimet e kuvendit të komunës, mos publikimi i të gjitha dokumenteve në gjuhët zyrtare, mos ofrimi i të dhënave biografike, mos ofrimi i materialeve përcjellëse për dëgjimet buxhetore, mos organizimi i takimeve publike sipas ligjit, janë indikatorë që janë vlerësuar pjesërisht transparent gjatë vitit 2020.



REKOMANDIMET

➤ **Komunat të hapin të dhënat publike në formatin “Open Data”.**

Shumica dërrmuese e komunave nuk ofrojnë të dhëna në formatin “Open Data”, që mundëson përpunimin e këtyre të dhënave. KDI rekomandon komunat që të përshpejtojnë hapat në ofrimin e të dhënave e dokumenteve publike në format e përpunueshme si mundësi shtesë për analizim dhe përpunimit e këtyre të dhënave nga ana e qytetarëve dhe grupet tjera të interesit.

➤ **Komunat të bëjnë të disponueshme për publikun materialet përcjellëse për pikat e rendit të ditës të seancave të Kuvendeve Komunale.**

Një numër i madh i Kuvendeve të Komunave nuk publikojnë materialet përcjellëse për pikat e rendit të ditës. Kjo qasje ka minimizuar informimin e qytetarëve për procedurat vendimmarrëse nga organi më i lartë vendimmarrës. KDI rekomandon të gjitha kuvendet e komunave që nuk praktikojnë publikimin e materialeve për pikat e rendit të ditës para mbajtjes së seancave, të fillojnë ti praktikojnë. Kjo qasje, rrit mundësitë e informimit të përgjithshëm të qytetarëve për proceset vendimmarrëse në nivel lokal.

➤ **Komunat të transmetojnë drejtpërdrejt seancat e Kuvendeve të Komunave.**

Qasja në punën e kuvendeve të komunave nga ana e qytetarëve mbetet sfiduese nga mosgatishmëria e kuvendeve për të ofruar transmetimin e drejtpërdrejtë të punimeve të seancave të kuvendeve të komunave. KDI rekomandon kuvendet e komunave të transmetojnë drejtpërdrejt seancat e kuvendeve përmes ueb faqes së komunave, si një si një mundësi për të rritur prezencën e publikut në punimet e kuvendeve të komunave.

➤ **Kuvendet e Komunave të përfshihen në organizimin e dëgjimeve buxhetore.**

Kuvendet e komunave vazhdojnë të mbesin vetëm miratues të planeve buxhetore duke përfshirë miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) si dhe miratimin e buxhetit të komunës. Si organe politike përfaqësuese, kuvendet e komunave duhet të përmbushin obligimet e tyre ligjore në organizimin e dëgjimeve për KAB si dhe për draft buxhetin e komunës. Kjo partiakë, në njërin anë do të siguronte përmbushjen e obligimeve ligjore dhe në anën tjetër kuvendeve të komunave do t'i mundësonte të kenë rol aktiv në planifikimet buxhetore në nivel lokal siç janë KAB dhe buxheti i komunës.

➤ **Të konsolidohen Këshillat Lokal dhe të rritet bashkëpunimi i institucioneve me këta mekanizma.**

Një ndër mekanizmat institucional për rritjen dhe sigurimin e pjesëmarrës së qytetarëve në proceset vendimmarrëse mbeten Këshillat Lokal. Shumica e komunave nuk kanë konsoliduar këta mekanizma bazuar në ndryshimet e fundit të legjislacionit si dhe publikimi i kontakteve të Këshillave Lokal në ueb faqet e komunave. Përtej kësaj, disa nga kuvendet nuk kanë arrit të kenë takimet e rregullta për çështjet e karakterit lokal. Kjo qasje institucionale, ka zbehur rolin dhe



funksionimin e këtyre mekanizmave për të ndikuar në nxitjen dhe rritjen e pjesëmarrjes të qytetarëve në proceset vendimmarrëse. KDI rekomandon komunat që të vazhdojnë me konsolidimin e Këshillave Lokal si dhe rritjen e bashkëpunimit me këta mekanizma me qëllim të përfshirjes së tyre në hartimin dhe zbatimin e politikave publike në nivel lokal.

➤ **Të rritet transparenca e komunave në rolin dhe angazhimin e tyre rreth integriteteve evropiane.**

Komunat kanë për obligim në përmbushjen e agjendës evropiane. Si rezultat i këtyre obligimeve të komunave, janë themeluar edhe Zyrat për Integritim Evropian në nivel lokal. Këto zyra institucionale kanë për obligim të raportojnë në baza të rregullta në nivelin qendror në përmbushjen e agjendës evropiane. Megjithatë, pak komuna vazhdojnë të ofrojnë informata për qytetarët sa i përket përmbushjes së obligimeve të tilla. KDI rekomandon komunat që të publikojnë informatat dhe raportet e ndryshme nga niveli lokal në arritjen e përmbushjes së agjendës evropiane.

➤ **Të përkthehen dokumentet dhe të ofrohen qasje e njëjtë në ueb faqet e komunave në gjuhët zyrtare.**

Komunat obligohen në respektimin e plotë të legjislacionit sa i përket përdorimi të gjuhëve zyrtare në nivel komunal si dhe në ofrimin e gjitha informacioneve në ueb faqe e komunave duke respektuar legjislacionin në fuqi. Shumë komuna, nuk kanë arritur të përmbushin obligimet në përkthimin e çdo dokumentacioni në nivel lokal si dhe të mos ofrojnë informata të barabarta në gjuhët zyrtare në nivel lokal përmes ueb faqeve zyrtare. KDI rekomandon komunat të respektojnë ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare, ngase kjo qasje mundëson informata të njëjta për gjithë qytetarët që nuk kuptojnë njërin nga gjuhët zyrtare.

➤ **Komunat të ndërtojnë mekanizma që mundësojnë regjistrimin sistematik të kërkesave të qytetarëve dhe ofrimin e informatës mbi statusin e tyre.**

Komunat përmes sistemit të brendshëm të intranetit, kanë mundësi të pasqyrimi të saktë të kërkesave dhe statusin aktual të kërkesave. Megjithatë, përkundër avancimit dhe zhvillimit të teknologjisë informative, komunat nuk kanë arritur të ofrojnë qytetarëve një mundësi që paralelisht të përcjellin regjistrimin e kërkesave si dhe statusin e këtyre kërkesave. KDI me qëllim të rritjes së komunikimit ndërmjet institucioneve dhe qytetarëve rekomandon institucionet lokale të ofrojnë një mundësi shtesë që përmes platformave elektronike të përcjellin statusin e kërkesave të tyre në procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit nga ana e institucioneve.

➤ **Komunat të ofrojnë linjë telefonike pa pagesë për qytetarët.**

Ofrimi i mundësive për komunikim shtesë me qytetarët të cilat nuk kanë kosto financiare mbetet i një rëndësie të veçantë. Deri më tani pak komuna kanë investuar në një ofrim të mundësive të tilla për qytetarët e saj. KDI vazhdon të rekomandon komunat që të ofrojnë linjë direkte telefonike pa pagesë, ku qytetarët do të kenë mundësitë e pasqyritit të shqetësimeve dhe kërkesave eventuale pa ndikim financiar për ekonomitë familjare.





Aleanca Qytetare për Transparencë (AQT) është themeluar në vitin 2020, në përbërje të disa organizatave lokale duke përfshirë: OJQ Mundësia, OJQ Fortesa, OJQ IQS, OJQ SHIP, OJQ FOJK si dhe KDI. AQT gjatë vitit 2021 është plotësuar edhe me anëtarë të rinj për të mbuluar komunat e rajonit të Prishtinës (Initiative for Social Education - ISEP), komunat e rajonit të Ferizajt (OJQ Avonet), komuna e rajonit të Gjakovës (SHL-Kosova), komunat e rajonit të Prizrenit (OJQ Sofra). AQT ka për synim të avokoj dhe lloboj tek institucionet lokale dhe qendrore në rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien institucionale.

Projekti financohet nga:

